



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

**P.nr.627/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të pandehurit B.A.i nga fshati ... K ... për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.906/16, të datës 18.05.2016, kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr.906/16, të datës 18.05.2016 më datën 14.06.2018, mori këtë :

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :**B.A.**, i lindur më data e lindjes..., në fshatin ... K.... ku edhe jeton, me nr. Personal: ...,punon ...t në kompaninë “ ... ”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili,

**Është fajtor**

Sepse me datën 13.05.2016, rreth orës 13:00min, në ..., në rrugën “ ... ” ka dëmtuar një kabull-fije optike të paisjeve tele-komunikuese –internetit të Kompanisë ..., në atë mënyrë që me bagerin e tij fillon ti kryej punët me të cilat ishte i ngarkuar prej kompanisë së vet ,lehtë mendon se edhe përkundër veprimeve të ndërmarra nuk do ti shkaktoj dëm askujt, mirëpo për një moment nuk kujdeset sa duhet dhe me pjesën e krahut të këtij bageri e kapë kabllon e lartpërmendur i cili ishte vendosur nën 4 metra dhe të njëjtin e këput, me ç rast shkakton çrregullime në furnizimin e popullsisë me rrjetë të TV-së dhe internetit, ndërsa edhe dëme kompanisë së lartpërmendur në vlerë rreth 250-300 euro.

-me çka ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s  
Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 41, 46 dhe 73 të KPK, si dhe nenit 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurës i shqipton,

**DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që të pandehurit B.A., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **dyqind (200) euro**, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të

përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

*Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.*

*Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit B.A. nga fshati ... K ... për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjën e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.*

*Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit B.A., dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor.*

*Në bazë të deklaratës së të pandehurit, e përfaqësuesit të dëmtuarit dhe deklaratën e dëshmitarit M.G., dhe foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri B.A. nga fshati ... K ... për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

*Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e PTH dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP.*

*Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr. 627/16, Më 14.06.2018**

**Sekretarja juridike,**

**Igballe Azemi d.v**

**Gjyqtari,**

**Behar Ymeri d.v**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.